

UDHËZIM
Nr. 18, datë 3.6.2013

PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 19.1.2009 “PËR RASTET E SHITJES, TRANSFERIMIT TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË LICENCUARA TË LOJËRAVE TË FATIT”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 10/5 të ligjit nr. 10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Pika I ndryshohet si vijon:

“I. Shoqëritë e licencuara në fushën e lojërave të fatit duhet të paraqesin pranë NJMLF-së për shitjen dhe çdo formë tjetër të disponimit të aksioneve të tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:”.

2. Pika II ndryshohet si vijon:

“Subjektet juridike apo fizike që kërkojnë të blejnë aksionet e shoqërive të licencuara në fushën e lojërave të fatit, duhet të paraqesin pranë njësisë së mbikëqyrjes së lojërave të fatit dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Regjistrimin si person juridik me objekt veprimtarie në fushën e lojërave të fatit, aktin e themelimit, statusin e shoqërisë dhe NIPT-in.

2. Deklaratat e burimit të kapitalit, shumave të tjera që do të investohen për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit.

3. Vërtetim nga organet tatimore që shoqëria nuk ka detyrime të pashlyera.

4. Vërtetim që shoqëria nuk është në ndjekje penale, në likuidim e sipër apo falimentim.

5. Nëse blerësi është person fizik, duhet të paraqesë paraprakisht pranë NJMLF-së, vërtetim se nuk është i dënuar për veprimtari në fushën e lojërave të fatit, mashtrim apo falsifikime, vetëdeklarim që disponon mjete të mjaftueshme financiare për organizimin e lojërave të fatit, si dhe deklaratë për burimin e kapitalit.”.

3. Pika III ndryshon si vijon:

“Shoqëritë e licencuara për ushtrim veprimtarie për kazino, për shitjen e aksioneve, transferimit, lënies peng apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre, të paraqesin në NJMLF këto dokumente:”.

4. Pika IV ndryshon si vijon:

“Subjekti që do të blejë aksionet e shoqërisë në veprimtari kazino, duhet të paraqesë në NJMLF këto dokumente:”.

5. Pika IV.6 ndryshon si vijon:

“Ndalohet dhënia me qira e pajisjeve elektronike që shërbejnë për ushtrim veprimtarie lojërash fati, subjekteve të papajisura me leje për ushtrimin e kësaj veprimtarie.”.

6. Pas pikës 6, shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“Në rastet e shitjes apo transferimit të aksioneve të shoqërive të licencuara për lotarinë kombëtare, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 95/2013, datë 4.3.2013.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode